



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 247/3 Prot.

Tiranë, më 18.03.2022

V E N D I M

Nr. 56 , Datë 18.03.2022

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr. 40, datë 09.02.2022, të paraqitur nga ankuesi I.S kundër Kryetarit të Bashkisë Pustec, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (*në vijim Komisioneri*),

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesi I.S parashtron se, është me profesion elektrikist dhe për një periudhë 2 vjecare ka punuar në OSHE, në agjensinë elektrike Bilisht. Ai shpjegon se, gjatë fushatës partiake, kryetari i PS i zonës J.A, i dërgon një letër partisë që ta pushojë nga puna, sepse në fushat kishte mbështetur LSI si dhe është paraqitur në zyrat e OSHE, ku ankuesi punonte duke kërkuar nga drejtuesi largimin e tij nga puna. Pas shumë ndërhyrjeve ankuesi shprehet se është larguar nga puna, ku më pas ka hapur proces gjyqësor të cilin e ka fituar.

Ankuesi deklaron se më pas ka filluar punë si elektrikist pranë Bashkisë Pustec. Gjatë zgjedhjeve vendore ankuesi deklaron se mbështeti kryetarin që ishte në atë kohë në drejtimin e bashkisë z. Themelko, i cili nuk fitoi. Sipas ankuesit kryetari i ri i bashkisë që ditën e parë e ka thirrur në zyrë duke i kërkuar të jepte dorëheqjen, sepse nuk kishte votuar për të. Gjatë gjithë kohës presionet kanë qenë nga më të ndryshmet. Sipas ankuesit, i jepej punë jashtë zanatit, nuk i jepeshin materialet e nevojshme për kryerjen e punës, deri sa një ditë nuk kundërshtoi më dhe ka bërë punët që i jepeshin.

Më pas, Kryetari i Bashkisë e ka thirrur përsëri në zyrë dhe i ka thënë se ishte në punë pa kontratë pune dhe nëqoftëse nuk do të jepte dorëheqjen do ta detyronte të rikthente në shtet pagat që kishte marrë dhe do ta fusnin në burg për shkelje.

Kur ka kërkuar lejen e zakonshme, i është komunikuar se kërkesën duhet ta bënte me shkrim. Ankuesi ka depozituar kërkesën për lejen e zakonshme me shkrim por konfirmimin e saj e ka marrë gojarisht nga juristi i bashkisë, i cili i ka komunikuar se leja ka filluar në datën që e kishte kërkuar. Ankuesi, deklaroi se i ka kërkuar Kryetarit të Bashkisë konfirmimin me shkrim të lejes, por edhe ai i ka komunikuar të njëjtën gjë. Pas disa ditësh ankuesi deklaroi se e kanë thirrur në zyrë duke i thënë “*ti pse nuk vjen në punë?*” Ankuesi ka shpjeguar se ishte me leje, por bashkia kishte hartuar një shkresë ku ishte vendosur një datë tjetër për fillimin e lejes e cila nuk ishte sipas kërkesës së tij. Pasi është konfliktuar në zyrën e Kryetarit të Bashkisë, është nxjerrë forcërisht nga zyra dhe më pas i kanë njoftuar largimin nga puna.

Në kushtet e presionit për ta hequr nga puna, ankuesi deklaroi se është detyruar që të paraqesë dorëheqjen për t’u larguar nga puna.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe dëmshpërblim nga institucioni.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale. Ankuesi nuk kishte dorëzuar kopje të aktit të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës si dhe mangësi në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit.

Fillimisht ankuesi u kontaktua në numrin e celularit të vendosur si kontakt në formularin e ankesës për plotësimin e të metave dhe më pas me shkresën nr. 274/1 prot datë 21.2.2022, ankuesit iu kërkuar :

- Kopje e aktit të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës
- Fakte dhe prova mbi bazën e të cilave ankuesi provonte bindjet politike

Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, me shkresën nr.274/2 prot datë 3.2.2022, ankuesi depozitoi kopje të urdhrit nr.38, datë 28.2.2020 “*Për ndërprerjen e kontratës së punës të z.I. S me detyrë elektrikist*”, të Kryetarit të Bashkisë Pustec. Ankuesi nuk depozitoi fakte shtesë ose prova mbi bazën e të cilave të provonte bindjet e tij politike.

Bazuar në aktet e administruara, rezultoi se, ankuesi ka filluar punë si elektrikist pranë Bashkisë Pustec në datën 27.3.2018, bazuar në vendimin nr.4, datë 27.3.2018, të Kryetarit të Bashkisë Pustec. Ankuesi ka punuar në këtë detyrë deri në datën 28.2.2020 kur janë ndërprerë marrëdhëniet e punës sipas urdhrit nr.38, datë 28.2.2020, të Kryetarit të Bashkisë Pustec.

Bazuar në aktet e depozituara nga ankuesi, në datën 18.10.2019, ankuesi ka paraqitur kërkesën për kryerjen e lejes vjetore duke filluar nga data 30.10.2019. Me shkresën nr.1052/1 prot datë 5.11.2019, të Kryetarit të Bashkisë Pustec është bërë miratimi i lejes vjetore për ankuesin duke filluar nga data 10.11.2019 deri në plotësimin e 4 javëve kalendarike.

Me shkresën nr.1296 prot datë 17.12.2019, të Kryetarit të Bashkisë Pustec, ankuesi është njoftuar për fillimin e procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës për shkak të mospërmbushjes së detyrës funksionale dhe mosparaqitje në punë për 7 ditë pa shkaqe të arsyeshme.

Në datën 24.12.2019, ankuesi ka paraqitur kërkesën për dorëheqje nga puna. Referuar kopjes së dorëheqjes, ankuesi deklaroi se kërkon të largohet nga puna në datën 29.2.2020, për arsye personale dhe familjare.

Me urdhrin nr.38, datë 28.2.2020 “Për ndërprerjen e kontratës së punës të z.I.S me detyrë elektrikist”, të Kryetarit të Bashkisë Pustec, është bërë ndërprerja e marrëdhënies së punës midis ankuesit dhe Bashkisë Pustec, bazuar në dorëheqjen e paraqitur nga ankuesi në datën 24.12.2019.

Ankuesi ka depozituar ankesën pranë Komisionerit duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të bindjeve politike pasi nuk është larguar me vullnetin e tij, por është detyruar të paraqesë dorëheqjen nga puna si pasojë e presioneve nga ana e punëdhënësit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “ç” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, (në vijim LMD) ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: a) shfuqizuar; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit për komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji; c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja; ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja e dijeni për sjelljen diskriminuese”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim, bazuar në arsyetimin vijues:

Së pari: Ankuesi nuk përcakton një datë të caktuar kur ka ndodhur apo kur ka marrë dijeni për diskriminimin e pretenduar. Ai ka përcaktuar në formularin e ankesës se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur në vitin 2019 dhe ai ka marrë dijeni në vitin 2019. Bazuar në faktet dhe rrethanat e konstatuara, rezulton se ankuesi i referohet momentit kur ka paraqitur dorëheqjen e cila mban datën 24.12.2019, duke pretenduar se ky është momenti i diskriminimit. Ankuesi ka depozituar ankesën në datën 09.02.2022.

Rezulton nga aktet e administruara se, ndërprerja e marrëdhënies së punës është bërë me urdhrin nr. 38 datë 28.2.2020 “Për ndërprerjen e kontratës së punës të z.I.S me detyrë elektrikist”, të Kryetarit të Bashkisë Pustec. Për rrjedhojë Komisioneri konstaton se, momenti i zgjidhjes së kontratës së punës shënon momentin kur kanë ardhur pasojat e dorëheqjes që ankuesi pretendon se e ka bërë në kushtet e presionit. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, ankesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar në nenin 33, pika 4, germa “dh”, të LMD.

Së dyti: Në nenin 1 të LMD-së përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, **bindjet politike**, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga LMD , në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Ankuesi pretendon se është diskriminuar për shkak të bindjeve politike, duke pretenduar se është detyruar të japë dorëheqjen nën presionin e Kryetarit të Bashkisë Pustec, për shkak se në zgjedhjet vendore nuk ka mbështetur kryetarin aktual të Bashkisë Pustec, por ka mbështetur ish kryetarin e kësaj bashkie, z. Edmond Themelko. Për të mbështetur pretendimet e tij ankuesi ka depozituar një foto, ku paraqiten rreth 25 persona të cilët janë fotografuar së bashku me z. Edmond Themelko, përpara një ndërtese, e cila nuk ka shenja identifikuese. Identifikimi i ankuesit referuar kartës së identitetit të depozituar dhe pamjes fotografike paraqet vështirësi. Nga sfondi i pamjes fotografike të depozituar, nuk konstatohen simbole politike. Imazhi fotografik i vendosur në dispozicion nuk ofron asnjë mundësi për të identifikuar se ku dhe kur është bërë fotoja e depozituar. Ankuesi nuk depozitoi asnjë informacion shtesë në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit edhe pas kërkesës për plotësimin e informacionit dërguar me shkresën 274/1 prot., datë 21.02.2022.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se pretendimet e ankuesit lidhur me bindjet e tij politike mbeten të karakterit deklarativ dhe të paprovuara. Provueshmëria e shkakut të diskriminimit, në rastin konkret bindjet politike, për të cilin ankuesi pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat, pra largimi nga puna, është thelbësore. Ankuesi nuk arriti të provojë shkakun e pretenduar të diskriminimit, atë të bindjeve politike. Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se, ky pretendim mbetet i karakterit deklarativ, i paprovuar apo mbështetur në prova të tjera, të drejtëpërdrejta apo të tërthorta.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë. Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkakut të pretenduar nga ankuesi, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, lidhur me pretendimin e tij për diskriminim për shkak të bindjeve politike.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “ç”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga ankuesi I.S kundër Kryetarit të Bashkisë Pustec nuk mund të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, lidhur me pretendimin e tij për diskriminim për shkak të bindjeve politike dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32/1/a , nenin 33, pika 4, gërma “ç” të Ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr. 40 regj., datë 9.2.2022, të paraqitur nga ankuesi I.S kundër Kryetarit të Bashkisë Pustec, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Bindjet politike
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Mospranim